

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA KOMUNALE  
SKENDERAJ

Nr. 02-332/05-0040301/18  
Data 17.07.2018

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA GLOGOC  
MUNICIPAL GLOGOC

01 Nr. 332-41395  
Data 17.07.2018

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUSHTRRI

02 Nr. / Br. 917/18  
Nr. i fq. / Br. sh. -03-  
Data / Datum 17.07.2018

VUSHTRRI - VUSHTRRI



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC

DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Republika e Kosovës

Delës-Izazna

Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Br. 6/4

Data 17.07.2018  
Datum

OBILIO-OBILIC

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA

02 Nr. 01-332/05-0056570/18  
Nr i fq./Br.sh. \_\_\_\_\_  
Data/Datumi 18.07.18  
Shtypja/Insc. Mitrovicë - Mitrovica



KOMUNA  
MITROVICË

KOMUNA  
SKËNDERAJ

KOMUNA  
DRENAS

KOMUNA  
VUSHTRRI

KOMUNA  
OBILIQ

## MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

Palët nënshkruese

1. Komuna e Skenderajt, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
2. Komuna e Mitrovicës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
3. Komuna e Drenasit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
4. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
5. Komuna e Obiliqit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës

R.L

K.H.T

**Neni 1**  
**Qëllimi i Memorandumit**

1. Qëllimi i këtij Memorandumit të Mirëkuptimit është që pasuria natyrore e bjeshkëve të Qyqavicës, e cila shtrihet në territorin e pesë (5) komunave të përfshira në këtë Memorandum Mirëkuptimi, të shpallet zonë me interes të përgjithshëm.
2. Zona e Qyqavicës do të shërbejë si urë lidhëse në mes të pesë (5) Komunave të lartcekura, duke përfshirë edhe tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe më gjerë.
3. Me rastin e shpalljes së kësaj zone me interes të përgjithshëm do të krijohet një zonë turistike, rekreative, kulturore dhe biznesore, duke ndikuar në rregullimin e ambientit, kujdesin ndaj ujërave si dhe sipërfaqeve të gjelbëruara.

**Neni 2**  
**Obligimet e palëve nënshkruese**

1. Palët nënshkruese obligohen të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe të shprehin gatishmërinë për bashkëpunim në realizimin e projekteve të përbashkëta.
2. Palët nënshkruese po ashtu obligohen që të llobojnë dhe të kërkojnë nga Qeveria e Republikës së Kosovës mjete financiare për ndërtimin e rrugës në gjatësi rreth 18 kilometrave, për t'i lehtësuar investimet në këtë zonë.

**Neni 3**  
**Ndërtimet e mundshme në Qyqavicë**

1. Në zonën e Qyqavicës, sidomos në majat malore të kësaj pjese, do të ndërtohet fillimisht rruga për të lehtësuar krijimin e zonës turistike, biznesore dhe kulturore, në pjesët në të cilat traseja e rrugës është më e përshtatshme për qarkullim.
2. Në pikat më të larta të bjeshkëve të Qyqavicës do të mund të ndërtohet spitali regional i mushkërive, fusha me terrene sportive, qendra rehabilituese për të moshuarit, krijimi i mini-liqeve artificiale, hotele dhe ndërtime të tjera rekreative, turistike dhe kulturore.

**Neni 4**  
**Zgjidhja e kontesteve**

Palët pajtohen në mes vete që ky Memorandum i Mirëkuptimit, të zgjidhet mes tyre me mirëkuptim.

R.21






Xh-T  
2

**Neni 5**  
**Dakordimi në mes të palëve**

Të gjitha çështjet e precizuara në këtë marrëveshje do të zbatohen me përkushtimin maksimal të palëve dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

1. Palët nënshkruese të këtij memorandumi pajtohen që ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi vetëm nëse kjo Marrëveshje aprovet nga Kuvendet e Komunave përkatëse konform nenit 40.2 shkronja (j) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale,
2. Ky Memorandum i Mirëkuptimit është nënshkruar në pesë (5) kopje dhe secilës palë nënshkruese i dorëzohet nga një (1) kopje.

 Komuna e Mitrovicës Kryetar i Komunës Agim BAHTIRI	 Komuna e Skenderbeut Kryetar i Komunës Belim JASHARI	 Komuna e Meranasit Kryetar i Komunës RamëLLA DROVCHI	 Komuna e Vushtrisë Kryetar i Komunës Xhafer TAHIRI	 Komuna e Obiliqit Kryetari i Komunës Xhafer GASHI
---	---	--	---	--